



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:040624  
Datë: 29.10.2024  
Numri i dokumentit: 06367275

**Ac.nr.8626/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Frosina Sylejmani e Besnik Feka - anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.T., nga Gjilani, rr. "...", nr.... të cilin me autorizim e përfaqësojnë av.H.A. dhe av.A.T.1., të dy nga Gjilani, kundër të paditurve: H.L., nga Gjilani, rr.“...”, nr...., D.M. dhe D.Z., të cilët i përfaqëson përfaqësuesja e përkohshme e caktuar av. A.S., nga Gjilani, dhe Komuna e Gjilanit të cilën e përfaqëson juristi B.M., nga Gjilani, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - departamenti i përgjithshëm, C.nr.15/2008, të datës 03.09.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur më datën **28.10.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e paditësit A.T., nga Gjilani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - departamenti i përgjithshëm, C.nr.15/2008, i datës 03.09.2021, **VËRTETOHET.**

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.15/2008, të datës 03.09.2021, në pikën *I (një)* të dispozitivit ka vendosur që ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit A.T. nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi në bazë të veprimit juridik të këmbimit është pronar i ngastrës kadastrale P-70403013-02465-1 ZK-Gjilan, në sipërfaqe prej 589 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Kamnik” me kulturë arë e klasit të parë e cila në veri kufizohet me rrugën publike të asfaltuar në gjatësi prej 47.98 m, në jug me rrugën publike të asfaltuar në gjatësi prej 46.33 m, në lindje me rrugën publike të asfaltuar në gjerësi prej 13.54 m dhe në perëndim më pronën private në gjerësi prej 97 m, e cila aktualisht në DGJKP në Gjilan, evidentohet në emër të S.K., që paditësit t’ia njohin këtë të drejtë të paditurit dhe i njëjti në DGJKP në Gjilan të regjistrohet në cilësi të pronarit të kësaj ngastre, tërë këtë në afat prej 15

ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në pikën *II (dy)* të dispozitivit e ka aprovuar prapësimin-kundërshtimin e të paditurës Komuna e Gjilanit dhe shfuqizohet aktvendimi i kësaj gjykate lidhur me caktimin e masës së sigurisë i datës 02.04.2021 me të cilën i është ndaluar të paditurës – kundërpropozueses të masës së sigurimit Komunes së Gjilanit, që vet ose përmes kontraktuesve të saj, të betonojë, asfaltojë ,të ndërtoj objekte, qoftë të vogla ose të larta, të mih ose në çfarë do forme tjetër të bëjë ndryshimin e gjendjes ekzistuese të datës 31.03.2021 në pjesën e ngastrës kadastrale me nr. P-70403013-02465-1 në vendin e quajtur “Kamnik”, ZK Gjilan në sip. 589 m<sup>2</sup>, e cila kufizohet në veri me rrugën publike të asfaltuar në gjatësi prej 47.98 m, në jug me rrugesn publike të asfaltuar në gjatësi prej 46.33 m, në lindje me rrugën publike me rrugën e asfaltuar në gjatësi prej 13.54 m, dhe në perëndim me pronën private në gjerësi prej 14.97 m, e cila sipas Certifikatës së Pronës me nr. të lëndës 12451-2018 të dt.11.12.2018 evidentohet ne DGJKP , në emër të S.K. (D...) nga Gjilani tani me vendbanim të panjohur, deri në përfundim të këtij kontesti civilo-juridik. Në pikën *III (tre)* të dispozitivit obligohet paditësi që përfaqësueses së përkohshme av.A.S., në emër të përfaqësimit t’ia kompensojnë shpenzimet e procedurës, në shumë të përgjithshme prej 2,340.00 €, në afat prej 15 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi në afat ligjor ka paraqitur ankesë, përmes të autorizuarit të tij, duke e atakuar të njëjtin për shkak të *shkeljeve së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale*, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, ashtu që ta aprovon në tërësi kërkesëpadinë e paditësit ose çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim

Përmes përgjigjes në ankesë e paditura Komuna e Gjilanit ka kundërshtuar ankesën e palës paditëse duke propozuar refuzimin e saj dhe vërtetimin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës se dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*- Ankesa e paditësit është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 10.01.2008, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi kundër të paditurve për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur lidhur me kërkesëpadinë (çështjen kryesore) pas shqyrtimit të provave dhe të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.15/2008, të datës 03.09.2021, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar sekërkesëpadia e paditësit është e pabazuar për shkak se sipas dispozitave ligjore të nenit 44 të

Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësoresh Juridike ( vitit 1980) e drejta e pronësisë pushon me kalimin e sendit në pronësi shoqërore. Ky fakt vërtetohet me prova materiale siç është aktvendimi 10-465-134/80-01 i datës 14 Mars 1980, ku e paditura ka bartë pronën në pronësi të saj dhe sipas certifikatës së pronësisë tani figuron në emër të saj. Gjykata e shkallës së parë po ashtu ka theksuar se refuzoi kërkesëpadinë edhe në mungesë të provave pasi nuk u bind se paditësi është pronar juridik i ngastrës kadastrale P-70403013-02465-1 në vendin e quajtur “Kamnik”, ZK Gjilan në sip. 589 m<sup>2</sup>. Tutje ka shtuar sa i përket pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurit H.L., gjykata nuk e morri për bazë pasi që as paraardhësi i tij I.L., e as i padituri nuk kanë qenë pronar të ngastrës kadastrale e cila është objekt kontesti, pra marrëveshja verbale e pretenduar rezulton se është bërë mes paditësit dhe jopronarit. Gjykata e shkallës së parë në këtë aktgjykim vendosi edhe për masën e sigurimit të kërkesëpadisë duke e shfuqizuar masën e përkohshme ngase ka gjetur se nuk janë plotësuar kushtet e parapara në nenin 297 të LPK-së, sepse paditësi nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive. Gjykata vendosi edhe në lidhje me shpenzimet e procedurës më gjerësisht si në pikën III të dispozitivit të aktgjyimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala paditëse me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i aktgjyimit është i kuartë dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendosë si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar, e të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjyimit.

Edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse as për këtë bazë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjyimit të ankimit. Në rastin konkret, e në bazë të provave të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, paditësi me asnjë provë konkrete valide nuk ka arritur ta provojnë faktin se atij i takon e drejta e pronësisë në ngastrën kadastrale e cila është objekt i këtij kontesti. Kjo pasi që edhe çështja e regjistrimit të pronësisë për pronën kontestuese është sqaruar drejtë përmes aktgjyimit të Gjykatës së shkallës së parë, pasi që nga provat e administruar është vërtetuar se pronari i kësaj paluajtshmërie i plotëson të gjitha të drejtat e parapara sipas dispozitave ligjore në fuqi, pasi që deri në momentin e ushtrimit të kësaj padie, pronari i kësaj

paluajtshmërie (komuna e Gjilanit) nuk ka pasur asnjë kundërshtim në lidhje me këtë paluajtshmëri, pasi që nga viti 1980 kur kemi formimin zyrtar të kadastrit kjo ngastër evidentohet si pronë shoqërore - pronë e Komunës së Gjilanit dhe që nga ky vit nuk ka kurrfarë ndryshimesh në këtë drejtim. Andaj pretendimet e paditësit mbi këtë bazë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qendrojnë, për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese të cekura si në arsyetim të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e të cilat gjykata e shkallës së dytë nuk e pa të arsyeshme që t'i përsërisë edhe njëherë, i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pabazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditësit është i drejtë dhe i argumentuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata ankimore e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e drejtë të dispozitave materialo - juridike nga edhe ka rrjedhur pabazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësit. Me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko-Pronësore (1980), e poashtu edhe në Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Pronësore të viti 2009, parashihen kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë. Zbatimi i këtyre dispozitave në përputhje me konstatimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, argumenton plotësisht qëndrimin e kësaj të fundit se kërkesëpadia e paditësit në rastin konkret është e pathemeltë, ngase i njëjti nuk ka arritur ta provojë faktin se i ka plotësuar kushtet ligjore për të fituar të drejtën e pronësisë në ngastrën kadastrale kontestuese në pjesën të cilën pretendon. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar dhe në kuptim të dispozitave ligjore të lartcekura rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Pretendimet e paditësit se ngastra kontestuese ka qenë prone private dhe se e njëjta ka qenë objekt i shitblerjes të cilën paditësi e ka këmbyer me paraardhësin e të paditurit I.L., në vitin 1973 dhe nga ajo kohë ka hyrë në shfrytëzim në bazë të kontratës joformale, Gjykata e Apelit i vlerësoi si të paqëndrueshme për faktin se ashtu siç ka deklaruar gjykata e shkallës së parë prona e cila ka qenë objekt i shitblerjes në atë kohë kur pretendohet të jetë bërë këmbimi mes paditësit dhe të paditurit I.L., nuk ka qenë e evidentuar në emër të këtu të paditurit të parë pra nuk ka qenë e evidentuar në emër të shitësit (I.L.), i cili ka këmbyer pronën me paditësin, ndërsa paditësi ky hyrë në marrëdhënie kontraktuese me jo pronarin, i cili nuk ka pasur kurrfarë të drejte apo autorizimi që ta tjetërsoi paluajtshmërinë kontestuese.

Pretendimet e paditësit të përsëritura në ankesë se i njëjti kishte hyrë në posedim dhe për shkak të moshës së shtyrë dhe laik pasitësi ka menduar se është ekspropriuar kjo parcelë dhe të njëjtën ka mbetur pa e shfrytëzuar, u refuzuan si të pabazuara. Lidhur me këtë, Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret çështja e posedimit nuk krijon raport pronësor e as të drejtë pronësie sepse në regjistrat kadastral, edhe në momentin e shpronësimit të pretenduar vet pala paditëse e paranon se prona kontestuese nuk ka qenë në pronësi të paditësit port ë personit tjetër, andaj lidhur me këtë eventualisht sa i përket kompensimit eventual vetëm ish pronari mund të

parashtrorë kërkesë brenda afatave të parapara ligjore, mirëpo në anën tjetër nuk ka qenë kontestuese se që nga viti 1980 kjo paluajtshmëri është në pronësi të paditurës Komuna e Gjilanit (mirëpo edhe nëse paluajtshmëria ka kaluar në pronësi shoqërore pa bazë juridike, e që pretendon pala paditëse sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi në atë periudhë kthimi i saj ka mundur të kërkohej në afat prej 5 viteve, duke filluar nga dita e marrjes në dijeni për këtë fakt, e më së voni në afat prej 10 vitesh).

Edhe sa i përket vendosjes lidhur me masën e sigurisë, është vlerësim i Gjykatës së shkallës së dytë se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në bazë të ligjit, pasi që nuk mund të caktohet masa e sigurimit pa u vërtetuar e drejta subjektive e paditësit-propozuesit, përkatësisht e drejta e vërtetimit të pronësisë, pavarësisht që fillimisht është aprovuar një propozimi i tillë dhe është caktuar masa, andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e aprovoi kundërshtimit e kundërpropozueses (të paditurës), ashtu që e ka shfuqizuar aktvendimin e gjykatës të datës 02.04.2021 me të cilin është caktuar masa e sigurisë.

Përfundimisht, kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime ishin të paqarta dhe nuk kishin të bëjnë me këtë çështje, dhe nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj, nga të lartcekurat, e në mbështetje të nenit 194 dhe 195 par.1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.8626/21, datë 28.10.2024**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari**  
**Arsim Hamzaj**